

RRITJA E PËRGJEGJSHMËRISË MENAXHERIALE KUSHT I RËNDËSISHËM PËR NJË QEVERISJE TË MIRË

nga Nikoleta PIRANJANI – Audituese e lartë,

botuar në gazetën “Ekonomia”, më 09 maj 2014.



Në Kongresin e VIII-të i INTOSAI-t të mbajtur në Lisbonë, në Qershor 2011, një nga dy temat e diskutuara dhe trajtuara gjerësisht ishte:

Sfidat, kërkesat dhe përgjegjësitë e menaxherëve publikë si dhe roli i SAI-ve.

Një rol dhe vend të rëndësishëm rritja e përgjegjshmërisë menaxheriale, zuri dhe në Planin Strategjik të Eurosai-t për vitin 2011 - 2017.

Për realizimin e objektivave të planit strategjik në drejtim të rritjes së përgjegjshmërisë menaxheriale rol të rëndësishëm luajnë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe kontrolli i jashtëm në sektorin publik.

Pa standardizimin e duhur, një vlerësim objektiv dhe i shëndoshë i performancës së menaxherëve publikë, nuk mund t’u kalohet qytetarëve. Në këtë mënyrë, standardizimi është një kusht paraprak për funksionimin e mirë të një shteti demokratik.

Situata si rrjedhojë e krizave aktuale financiare ka ringjallur nevojën për standardizim për të lehtësuar të kuptuarit dhe komunikimin në arenën ndërkombëtare dhe është pikërisht në kohën e krizës kur qytetarët kërkojnë veçanërisht kontroll efektiv, që kërkon midis të tjerave përshtatjen e standardeve profesionale për të siguruar funksionimin e duhur të SAI.

SAI-t nuk mund të mos ndikohen nga kërkesat e shoqërisë dhe duhet të promovojnë masa që kontribuojnë në transparencë dhe qeverisje të mirë dhe të rikthejnë besimin investitorëve dhe të qytetarëve, bazuar në kualitetin dhe besueshmërinë e informacionit.

Kjo kërkon përpjekje riorganizimi në menaxhimin publik, të plotësuar nga një auditim i përshtatshëm i kryer nën standardet ndërkombëtare dhe kriterit të performancës.

Sipas përpjekjeve të mëdha të INTOSAI-t, i mbështetur dhe nga nivelet më të larta të BE - së, është detyra e SAI - ve për të shtrirë miratimin dhe zbatimin e ISSAI - ve që të ndihmojë jo vetëm në një kualitet më të lartë auditimi, por dhe në përmirësimin e efektivitetit të tyre në shoqëri duke krijuar vlera për veten dhe subjektet.

Gjithashtu në Konferencën e parë të EUROSAI-ASOSAI ku vendet pjesëmarrëse sollën eksperiencat e tyre nga vendet e rajonit, ndër shtyllat kryesore të diskutimit ishin: transparencë, përgjegjshmëria dhe lufta kundër korrupsionit.

Në këtë sfidë për sigurimin e transparencës përgjegjshmërisë në Menaxhimin Financiar Publik, luajnë rol të rëndësishëm SAI-et e këtyre vendeve.

Në këtë pikë do të ishte shumë domethënëse që të mbështetemi fort në mesazhin e lëshuar nëpërmjet Deklaratës së Limës ku citohet se: "Auditimi nuk është një qëllim në vetvete, por një pjesë e domosdoshme e një sistemi rregullator".

Në këtë kuadër theksojmë se SAI-t janë një pjesë integrale e sistemit të Menaxhimit Publik Financiar dhe luajnë një rol kyç në mbështetjen e funksioneve kryesore të shtetit, duke përfshirë; sigurinë që fondet publike përdoren në përputhshmëri me ligjin, përmirësimin e efektivitetit të mbledhjes së të ardhurave të shtetit, si dhe forcimin e ambientit të kontrollit financiar për uljen e korrupsionit.

Në Shqipëri është miratuar ligji për sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe për këtë sqarojmë se, prezantimi dhe zhvillimi i KBFP-së (Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik) është i mbushur me sfida ku një prej tyre është "Përgjegjshmëria menaxheriale".

Në lidhje me këtë theksojmë se shpesh herë kjo përgjegjshmëri nga menaxhimi kuptohet si kontroll mbi gjithshka dhe në gjithshka. Kjo gjë shpesh çon në largimin e punonjësve nga proceset e kontrollit të brendshëm.

Fakti që menaxherët e lartë duhet të jenë të përgjegjshëm, nuk do të thotë që këto menaxherë duhet të kontrollojnë çdo transaksion të organizatës, nuk do të thotë që quhen përgjegjës në qoftë se marrin të gjithë vendimet personalisht. Në

qoftë se do të ndodhte kjo, këndvështrimi i ekipit të lartë menaxherial (ose organizatës në tërësi), mbi riskun, mundësitë dhe qeverisjen zhvlerësohet plotësisht, duke lënë vetëm atë të menaxherëve. Kjo situatë përkeqësohet aty ku emërimi i menaxherëve të lartë bazohet në konsiderata politike, më tepër se sa në aftësi menaxhimi. Një situatë e tillë padyshim, që çon në rregullime të dobëta të delegimit dhe ulje të eficiencës organizative. Konkretisht, shpesh kjo do të thotë se menaxherët e nivelit të ulët nuk janë plotësisht të sigurtë për buxhetin që kanë për të shpenzuar apo objektivat që duhet të realizojnë. Roli apo këshillimi nga departamentet financiare është i parëndësishëm apo shpërfillet, duke çuar në vendimmarrje financiare të pa bashkërenduar dhe ad hoc.

Ligji për buxhetin e shtetit si dhe për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ofrojnë dhe përcaktojnë kuptimin, përgjegjësitë dhe rregullat që duhet të funksionojnë për administratën dhe për institucionet publike (detyrim për zbatim), në drejtim të një menaxhimi efektiv dhe me përgjegjësi të qeverisjes se përgjithshme.

Sistemi i MFK-së parashikon (ndër të tjera): caktim të autoritetit dhe përgjegjësisë, fuqizim dhe përgjegjshmëri, si dhe linja të përshtatshme raportimi.

Të gjithë punonjësit, qoftë drejtorët, menaxherët apo specialistet, duhet të dinë rolin e vet, përgjegjësitë dhe kufijtë e autoritetit në këtë proces. Menaxherët duhet të kuptojnë procedurat dhe rëndësinë e delegimit duke pasur parasysh se: Ata mund të vazhdojnë ta ruajnë kontrollin e përgjithshëm, duke pasur një strukturë delegimi të përcaktuar qartë me përskrime pune, objektiva performance dhe tregues për të gjithë stafin. Mund të përmbushen më shumë detyra.

Çlirimi nga administrimi rutinë u lejon përqendrim më të qartë tek realizimi i objektivave të organizatës.

Po kështu, të gjithë menaxherët duhet të jenë të vetëdijshëm për objektivat e tyre operacionale dhe duhet të raportojnë mbi realizimin e këtyre objektivave si dhe mbi përdorimin e burimeve me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet. Menaxherët kanë përgjegjësi për menaxhimin e burimeve financiare në interes të publikut, pra jo vetëm të garantohen se fondet po shpenzohen në përputhje me ligjin, por edhe se ato po shpenzohen mirë. Në praktikë i kushtohet vëmendje përputhshmërisë ligjore por shumë pak shpenzimit të mirë të fondeve.

Për këtë duhet të ekzistojnë njësi organizative për çështjeve financiare. Sfida në këtë mes është që menaxhimi duhet të ndërregjegosohet se një sistem modern i

menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK) mund të përmirësojë qeverisjen e organizatës së tyre.

Përveç sa më sipër një rol të rëndësishëm në sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit luan dhe menaxhimi i riskut. Ai është një nga fushat jetësore e kontrollit të brendshëm dhe i referohet procesit të identifikimit dhe analizimit të risqeve në realizimin e objektivave të organizatës dhe në përcaktimin e reagimit të përshtatshëm për zbutjen e riskut. Menaxhimi i riskut ka të bëjë me dy procese të rëndësishme:

- a. me vlerësimin dhe klasifikimin e riskut si dhe
- b. përgatitjen e një reagimi ndaj riskut ose ngritjen e strategjisë ndaj riskut.

Gjithashtu, menaxhimi i riskut duhet të shqyrtohet dhe raportohet në mënyrë që të monitorohet. Monitorimi ka për qëllim përcaktimin, nëse po ndryshon apo jo profili i riskut dhe nëse menaxhimi i riskut është efektiv. Gjithashtu monitorimi i riskut ka për qëllim të identifikojë veprimet e mëtejshme që nevojitet në menaxhimin e riskut. Ai do të kthehet në praktikë standarde gjatë zbatimit nëpër institucione, vetëm nëse kuptohet mirë se çfarë do të thotë dhe nëse kuptohen të mirat që arrihen përmes tij, në kuptimin e shërbimeve të përmirësuara dhe realizimit të objektivave kyçe. Problemi i menaxhimit të riskut duhet të trajtohet në nivel qendror dhe brenda çdo ministrie.

Një lëvizje e tillë në menaxhimin e riskut drejt identifikimit të lire të risqeve të organizatës, paraqet një mundësi për të ndërtuar kulturën e qeverisjes së hapur brenda në organizatë. Një kulturë e tillë ecën përkrah përmirësimit të kulturës etike, ku çdo person ruan dhe demonstroi ndershmërinë personale dhe profesionale si dhe vlerat etike.

Kodi i Etikës, ndonëse nuk ka të njëjtin efekt si ligji, mbetet një dokument serioz, pasi çdo shkelje e kodit etik, edhe kur nuk ka shkelje ligjore, mund t'i kanosë rrezik të konsiderueshëm reputacionit të organizatës. Anëtarët dhe menaxherët kanë një përgjegjësi të veçantë në çeshtjet etike, meqenëse shembulli i tyre, ka një ndikim shumë domethënës në kulturën e organizatës, në këtë mënyrë ata duhet të jenë veçanërisht të vëmendshëm.

Rol të rëndësishëm në këtë proces si në drejtim të zbatimit të ligjit për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë ashtu dhe në drejtim të zbatimit të ligjit për MFK, ka luajtur dhe luan Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke përfshirë këtu zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në zbatim të tyre, duke dhënë opinione në

lidhje me zbatimin e kërkesave të ligjit, duke dhënë opinione në lidhje me funksionimin e sistemeve (fushave) që parashikon MFK, duke rekomanduar për çdo rast masat organizative të domosdoshme në funksion dhe në zbatim të ligjit. Të tilla mund të përmendim rekomandimet e dhëna në Ministri të Financave për nivel sistemi të gjithë institucioneve qendrore dhe lokale në lidhje me gjendjen dhe vendosjen sipas ligjit të emërimeve për nëpunësin Autorizues dhe Zbatues si dhe vartësinë strukturore të këtij të fundit direkt nga N/A (kërkesë e ligjit). Rekomandime të rëndësishme nga KLSH janë lënë në drejtim të nxjerrjes së akteve rregullativë të brendshëm, të përcaktimit të gjurmëve së auditimit në lidhje me miratimin e çdo shpenzimi buxhetor dhe përdorimi të çdo aseti apo malli, pronë e institucionit. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka dhënë opinione të rëndësishme në vartësi të shkeljeve të konstatuara se nëse brenda institucionit funksionon si dhe sa duhet kontrolli i brendshëm, kjo për vetë faktin, që titullari i institucionit të marrë opinion nga një auditim i pavarur për nivelin e menaxhimit dhe mangësitë e këtij menaxhimi në institucion.

Gjithashtu, brenda çdo Ministrie, funksioni i auditimit të brendshëm duhet të rrisë përqendrimin e auditimit tek çështjet e menaxhimit të riskut sërish për të promovuar të kuptuarin dhe përdorimin e tij.

Auditimi i qeverisjes është një element bazë për një qeverisje të mirë publike. Nisur nga fakti se suksesi i qeverisjes matet nga aftësitë e saja për të ofruar shërbime të suksesshme dhe realizimin e programeve të saj, në mënyrë të drejtë dhe të përshtatshme, veprimtaritë e auditimit të qeverisjes duhet të kenë domosdoshmërisht autoritetin, pavarësinë, aftësinë (profesionalizmin) për të vlerësuar integritetin dhe efektivitetin financiar.

Në këtë këndvështrim mungesa e auditimit të brendshëm apo cilësia e dobët e auditimit të brendshëm, do të thotë se rregullimet për kontrollin e brendshëm apo përqendrimi në menaxhimin e riskut, kanë pak gjasa të përmirësohen dhe se në këtë mënyrë rritet mundësia për mashtrim.

Çdokush është mjaft i vetëdijshëm se është e nevojshme që auditimi i brendshëm të jetë funksionalisht i pavarur dhe me përmbajtje profesionale. Shkalla e ulët e ndërgjegjësimit tek titullarëve kundrejt mbështetjes së funksionit të auditimit, kuptimit të rolit, përfitimeve si dhe dobive, vijon të ketë ndikime në mënyrën e organizimit dhe të realizimit të kësaj veprimtarie.

Edhe në këtë drejtim nga KLSH ka pasur mbikëqyrje të vazhdueshme duke dhënë në vazhdimësi opinionet përkatëse. Një nga pikësynimet e auditimit të KLSH ka qenë

identifikimi nëse ekziston një strukturë funksionale dhe e pavarur e auditimit të brendshëm, gjetja dhe identifikimi i shkeljeve fenomen në një institucion, analizimin e shkaqeve të tyre dhe gjithmonë këto janë shoqëruar me rekomandimet përkatëse në përmirësimet ligjore nxjerrjen e akteve rregullative plotësuese të akteve ligjore si dhe ngritjen e strukturave të auditimit funksionale.

Përmirësimi i vijueshëm i mjedisit për një kuptim dhe konceptim të drejtë të funksionit të auditimit të brendshëm për menaxhimin, do të synojë rritjen e ndërgjegjësimit dhe kuptimin e saktë të auditimit të brendshëm si mbështetje dhe ndihmë për menaxhimin e subjektit publik në përmbushjen e objektivave.

Në drejtim të rritjes së përgjegjshmërisë institucionale në si KLSH, për të kryer detyrat tona në mënyrë të paanshme dhe me kompetencë, duhet të dimë dhe të aplikojmë procedurat e përshtatshme ligjore dhe operative. Në veçanti, duhet të zbatojmë Standardet dhe Politikat e Auditimit të institucionit (SAI-t) si dhe standardet profesionale dhe metodat përkatëse të auditimit të IFAC dhe INTOSAI-t. Anëtarët dhe menaxherët kanë një përgjegjësi të veçantë për të siguruar që stafi të trajnohet në interes të shërbimit. Nevojat e zhvillimit të aftësive individuale duhet të adresohen në sistemin e vlerësimit të performancës së stafit.

Potenciali dhe aftësitë individuale të stafit duhet të merren në konsideratë kur caktohen përgjegjësitë. Anëtarët dhe menaxherët duhet të sigurojnë mbrojtjen e interesave të stafit. Ata mbajnë përgjegjësi të veçantë në mbrojtjen e stafit që zbulon dhe raporton keq-bërjen në kushtet e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme. Përpara se të merret një vendim, duhet të konstatojmë pikëpamjet tona në një mënyrë konstruktive dhe pasi të jetë marrë ky vendim, duhet ta zbatojmë atë në mënyrë efektive.

Duhet të kontribuojmë të gjithë në zbatimin e politikës së SAI-t për një komunikim të hapur të brendshëm dhe të jashtëm. Të qenit i hapur ka një efekt pozitiv në bashkëpunim. Informacioni i përshtatshëm duhet të ndahet me të tjerët, por njëkohësisht duhet të jemi të vetëdijshëm se çfarë informacioni posedojmë dhe kujt mund ti duhet për punën që kryen.

Ti shërbejmë interesave të qytetarëve, të cilët presin shërbime cilësore auditimi dhe një administratë të aksesueshme.

Të gjitha këto plotësojnë atë imazh dhe mesazh të përgjithshëm që kanë dhënë dhe japin Kongreset e Eurosai -t dhe që është: “ Një sfidë për SAI-t është që të jenë të forta, të pavarura.